

STATUTI I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

“MARRIN” Shpk

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, ortakët themelues të shoqërisë nënshkruajnë Statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, i cili përcakton objektin, të drejtat e detyrimet e shoqërisë si më poshtë:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
- “Ditë të Plota” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia dhe Adresa e Faqes së Internetit

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Më 11.08.2025, **Ümit Işık** shtetas turk, ka krijuar shoqërine me përgjegjësi të kufizuar me emrin “MARRIN” Shpk

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

-**Ümit Işık** shtetas turk, mbajtes i Pasaportes me Nr. S37848410

Neni 2:

Objekti

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: Import eksport, blerje shitje marketing e të gjitha llojeve të makinerive industriale dhe të punës, pjesëve të këmbimit, pajisjeve dhe ekipamenteve të tyre, prodhim i makinerive për perpunimin e aluminit, drurit, PVC dhe makinerive prerëse dhe shpuesë të perdorura në industri, prodhim i makinerive hidraulike, cilindrave hidraulike, makinerive pneumatike, motoreve hidraulike dhe automatike, si dhe pjesëve lidhëse, prodhim, riparim dhe montim i të gjitha llojeve të makinerive dhe veglave elektrike dhe elektronike, prodhimi i të gjitha llojeve të makinerive për perpunimin e tekstileve (makinat e ramit, përgatitjen e pelhurave, makinat e kthimit, makinat e ngjyrosjes, makinat centrifugale, makinat e hapjes së lagesht, makinat e hapjes së thate, makinat e shtypjes, prerjes, tharjes, makinat sanfor, prodhimi i paneleve elektrike dhe elektronike për keto makina, si dhe prodhimi, blerja shitja importi dhe eksporti i të gjitha materialeve dhe pjesëve të këtyre makinerive, prodhimi dhe marketingu i të

gjitha llojeve te makinerive dhe materialeve per ashensore, si dhe shitja me shumice dhe pakice etj.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Neni 4:

Selia, Adresa e Faqes së Internetit dhe Adresa Elektronike

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Lagja nr.1, Rruga Nacionale me zone kadastrale 2446, nr pasurie 8/407, Kati 4, hyrja Nr.8, Librazhd. Shoqeria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe ne te gjitha shtetet jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: <https://www.marrinmakina.com/>

(3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

umit@marrinmakina.com 0696476399 / 00905434041010

Kreu II

Kapitali i Regjistruar

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise do jete 100.000 (njeqindmije) Leke. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e meposhtem qe nenkuptohet i perbere nga 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme prej 100.000 leke. Kjo kuote i perket ortakut si me poshte:

Ümit Işık, zoterues i 1(nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 leke me pjesmarrje 100% ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

Neni 6

Menyra e fitimit dhe kalimit te kuotave

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;



- b) shitblerjes;
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- c) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj,

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Kreu III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 8: Organi Vendimmarres

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;

b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të këtij ligji, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortakua përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakua, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Cdo ndryshim në Statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 14

Administrimi

Asambleja e Ortakeve emeron një ose me shume të tjere persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejte rizgjedhje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(1) Administrator i parë i shoqërisë është: **Ümit Işık** shtetas turk, me pasaportë turke me Nr. S37848410. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejte rizgjedhje. Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 15

Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kanë të drejtë të detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të këtij ligji, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 16

Përgjegjësia e Administratorit

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit, për të perballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, administratori detyrohet:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar

kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

5. Dispozitat e pikës 6 të nenit 92 të këtij ligji zbatohen edhe për paditë, që rrjedhin nga paragrafët e këtij neni. Këto padi duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 17

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve. Në perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për pasqyrat financiare si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'i paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Kreu V

Neni 19

Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Neni 20

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëri mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblese së Ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Neni 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, dëto zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"MARRIN" Shpk

Ortaku

Ûmit Işık

Me Tërburë Mënyshkoi
Ar. Feriail Ruzaj
[Signature]